

Akt Themelimi
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“ALB-GOM ”Sh.p.k

Sot me date 13/02/2025 , ne te poshte shënuarit,

Matias Karroçi , shtetas Shqiptare , lindur në Tirane, më 07/07/1995 , madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim nr. 037687986

si themelues te kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, në të cilën jemi ortak, vendosem të hartojmë këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

Neni 1

Sot, më datë 13/02/2025 , ne themeluesit krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të quajtur **“ALB-GOM” sh.p.k.** Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar për aq kohë sa nuk do të merret një vendim për shndërrimin e saj në një formë tjetër shoqërie të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

Neni 2

Emri

Emri i plotë i shoqërisë është **“ALB-GOM”sh.p.k.**

Neni 3

Zyra Qendrore

Zyra Qendrore e shoqërisë do të jetë në adresen:

Lagjja Kongresi i Lushnjes, Rruga Vojo Kushi, pranë Kinoteatrit, Pallati Rezarti, Njësia E-A7/9P, Zyra DSME.mirel (nr. 0755), Kati i 2-të. Lushnje

Me vendim të Asamblesë se Ortakeve, zyra e shoqërisë mund të ndryshohet, të hapen filiale dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është e papërcaktuar, dhe do të fillojë nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendoset me vendim te Asamblesë se Ortakeve.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria tregtare “**ALB-GOM**”sh.p.k.ka si objekt veprimtarie:

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

- Përpunimi i guarnicioneve të ndryshme industriale për makina dhe pajisje elektroshtepiake.
- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë transportin e mallrave për nevojat e shoqërisë dhe palët e treta.
- Aktivitet fasonerie dhe industri përpunuese.
- Tregtim me pakicë dhe shumicë, si dhe eksportim i mallrave.

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali i shoqërisë do të jetë 50.000 (pesedhjetë mijë) Lekë, i zotëruar si më poshtë:

Nr	Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron
1	MATIAS KARROÇI	100 %	1 kuote

Ky kapital është i ndare në 1 (nje) kuote e cila është e ndare si më poshtë
Nje kuote është në vlerën 50.000 (pesedhjetë mijë) leke, përben 100% të kapitalit të shpk dhe zotërohet nga ortakut **MATIAS KARROÇI**.

Kapitali themeltar mund të depozitohet në një Bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

Neni 7

Administratori

Shoqëria do ketë 1 administratore administratore të shoqërisë do të jenë :

1- Matias Karroçi , shtetas Shqiptarë , lindur në Tirane, më 07/07/1995 ,
madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me
Letërnjoftim nr. 037687986

Kohëzgjatja e mandatit është 5 vjeçar me te drejte ripërtëritje.

Neni 8

Dispozita e fundit

Ky akt themelimi është hartuar në 2(dy) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.

THEMELUES


